

Me rastin e Asamblesë së Dhjetë të Gjyqtarëve të EULEX-it, të mbajtur në Gjilan, më 01 qershor 2010

Asambleja e përbërë nga gjyqtarët:

Maria Giuliana Civinini, Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it; Gerrit-Marc Sprenger, Antoinette Lepeltier-Durel, Arkadiusz Sedek, Charles Smith, Dragomir Yordanov, Eija-Liisa Helin, Emilio Gatti, Esma Erterzi, Ferdinando Buatier de Mongeot, Francesco Florit, Gabriele Gaube, Gianfranco Gallo, Guy Van Craen, Hajnalka Karpati, Harri Katara, Laura Plesa. Martti Harsia, Nikolay Entchev, Piero Leanza, Richard Winkelhofer, Riku Jaakkola, Rositza Buzova, Torsten Koschinka, Vergiinia Micheva-Ruseva, Vitor Pardal, Vladimir Kanev, Witold Jakimko.

Miraton VENDIMIN

Me 27 gjyqtarë të pranishëm gjatë votimit dhe me një gjyqtar në mungesë: me 25 vota për, dhe 2 abstenime për aprovimin e këtyre Udhëzimeve për caktimin e lëndëve penale për gjyqtarët e EULEX-it në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Maria Giuliana Civinini

Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

UDHËZIME PËR CAKTIMIN E LËNDËVE TË GJYQTARËVE TË EULEX-IT NË LËNDËT PENALE NË GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS

I. Baza Ligjore

Caktimi i lëndëve i Gjyqtarëve të EULEX-it do të bëhet në përputhje me Ligjin mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji Nr. 03/L-053), më tutje i referuar si LmK.

II. Parimet e sistemit për caktimin e lëndëve

- **Transparenca**
Caktimi i lëndëve duhet të jetë transparent për palët dhe publikun.
- **Objektiviteti**
Të gjithë duhet ta dinë paraprakisht nga cili gjyqtarë ai/ajo do të gjykohej (gjyqtarët nuk do t'i zgjedhin lëndët).
- **Fleksibiliteti**
Kushtet specifike të punës, numri i vogël i gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën Supreme dhe rregullat për përjashtim të përcaktuara me KPPPK duhet të merren parasysh.
- **Qëndrueshmëria**
Sistemi për caktimin e lëndëve duhet të jetë shembull i zbatimit të duhur të drejtësisë të cilin gjyqtarët vendor mund ta zbatojnë në mënyrë që t'i arrijnë qëllimet e një sistemi të pavarur, transparent dhe efikas gjyqësor.
- **Ndarja e barabartë e punës së gjyqtarëve**

III. Sistemi për caktimin e lëndëve

1. Dispozitat e përgjithshme:

- 1.1. Lëndët penale në Gjykatën Supreme të Kosovës do t'i caktohen gjyqtarëve penal të EULEX-it në Gjykatën Supreme si kryetar të kolegjit në bazë të dallimit rajonal. Në Kosovë janë pesë (5) rajone: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Pejë dhe Mitrovicë.
- 1.2. Rregullat e përjashtimit siç janë përcaktuar me KPPPK-në kërkojnë një dallim të mëtutjeshëm në mes të ankesave kundër Aktvendimeve, ankesave kundër Aktgjykimeve, mjeteve të jashtëzakonshme ligjore dhe ankesave tjera.

- 1.3. Renditja në mënyrë alfabetike në dispozitat në vijim i referohet mbiemrit. Prefiksi (p.sh. Van, Du) nuk konsiderohen si pjesë e mbiemrit.

2. Ankesat kundër Aktvendimeve:

2.1. Caktimi i kryetarit të kolegjit:

Rastet e ankesave kundër Aktvendimeve do t'i caktohen gjyqtarëve të EULEX-in në Gjykatën Supreme, përveç Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të BE-së, sipas renditjes në vijim:

- 2.1.1. Nëse gjykata e shkallës së parë ka selinë e saj brenda juridiksionit rajonal të Gjykatës së Qarkut në Pejë apo Mitrovicë, lënda do t'i caktohet gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën Supreme emri i të cilit është i pari në listën e bashkangjitur si Aneksi 1.
- 2.1.2. Nëse gjykata e shkallës së parë ka selinë e saj brenda juridiksionit rajonal të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe numri i lëndës së Gjykatës Supreme është çift, lënda do ti caktohet gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën Supreme emri i të cilit është i dyti në listën e bashkangjitur si Aneksi 1.
- 2.1.3. Nëse gjykata e shkallës së parë ka selinë e saj brenda juridiksionit rajonal të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe numri i lëndës së Gjykatës Supreme nuk është çift, lënda do ti caktohet gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën Supreme emri i të cilit është i treti në listën e bashkangjitur si Aneksi 1.
- 2.1.4. Nëse gjykata e shkallës së parë ka selinë e saj brenda juridiksionit rajonal të Gjykatave së Qarkut në Prizren ose Gjilan, lënda do ti caktohet gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën Supreme emri i të cilit është i katërti në listën e bashkangjitur si Aneksi 1.
- 2.1.5. Nëse gjyqtari të cilit duhet t'i caktohet lënda nuk është i pranishëm për shkak të përjashtimit ligjor, mungesës apo arsyeve të tjera të rëndësishme, lënda i caktohet Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të BE-së. Nëse Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të BE-së nuk është e pranishme për shkak të mungesës në ditën e shqyrtimit apo arsyeve të tjera, në mes tjerash urgjencën apo ngarkesën në punë, lënda i caktohet gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën Supreme, emri i të cilit është pas emrit të gjyqtarit të

EULEX-it në Gjykatën Supreme në listën e bashkëngjitur si Aneksi 1, në përputhje me nenin 2.1.1 deri në nenin 4.

2.2. Caktimi i anëtarëve të kolegjit:

- 2.2.1.** Është e pëlqyeshme që anëtarët e kolegjit të jenë gjyqtarë vendor të Gjykatës Supreme të caktuar në lëndë penale. Këta gjyqtarë vendor do të caktohen në kolegje në bazë të orarit – të bashkëngjitur si Aneksi 2 – i cili përmban të gjithë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të caktuar në lëndë penale.
- 2.2.2.** Caktimi i këtyre gjyqtarëve në kolegje do bëhet sipas emrave në renditje sipas alfabetit .
- 2.2.3.** Nëse gjyqtari vendor i cilit duhet të caktohet në kolegji nuk është i pranishëm për shkak të përjashtimit, mungesës apo arsyeve të tjera të rëndësishme, ai apo ajo do të zëvendësohet nga gjyqtari vendor emri i të cilit pason sipas orarit. Gjyqtari i cili është zëvendësuar do të caktohet si anëtar në kolegjin e ardhshëm.
- 2.2.4.** Nëse një gjyqtar i EULEX-it kërkohet si anëtar i kolegjit, ai apo ajo do të caktohet në kolegji në bazë të orarit – të bashkëngjitur si Aneksi 3 – i cili përmban të gjithë emrat e gjyqtarëve të EULEX-it në nivelin e Gjykatës së Qarkut. Caktimi i anëtarit të kolegjit duhet të përmbahet radhitjes alfabetike sipas emrit. Nëse ky gjyqtar nuk është i pranishëm për shkak të përjashtimit ligjor, mungesës apo arsyeve të tjera të rëndësishme, ai apo ajo do të zëvendësohet nga gjyqtari i EULEX-it emri i të cilit pason sipas orarit. Gjyqtari i cili është zëvendësuar do të caktohet si anëtar i kolegjit të ardhshëm.
- 2.2.5.** Nëse një gjyqtar i EULEX-it kërkohet si anëtar i kolegjit gjatë periudhës së kujdestarisë, do të caktohen gjyqtarët kujdestarë të EULEX-it në Gjykatat e Qarkut. Caktimi do të bazohet në renditjen rajonale në vijim:
1. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, nëse nuk është e gatshme
 2. Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, nëse nuk është e gatshme
 3. Gjykata e Qarkut në Gjilan, nëse nuk është e gatshme
 4. Gjykata e Qarkut në Pejë, nëse nuk është e gatshme
 5. Gjykata e Qarkut në Prizren.
- 2.2.6.** Në periudhën e kujdestarisë kryetari i kolegjit do të jetë Gjyqtari i EULEX-it në Gjykatën Supreme i cili identifikohet në bazë të orarit të kujdestarisë paraprakisht të përgatitur.

3. Ankesat kundër aktgjykimeve në shkallën e dytë:

3.1. Caktimi i kryetarit të kolegjit:

Lëndët aktgjykimi i të cilave është ankimuar në shkallën e dytë, në Gjykatën Supreme të Kosovës, u caktohen gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën Supreme në përjashtim të Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të BE-së, sipas këtij rendi:

- 3.1.1.** Nëse gjykata e shkallës së parë ka selinë e saj brenda juridiksionit territorial të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës dhe numri i lëndës së Gjykatës Supreme është çift, lënda i caktohet gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën Supreme, i cili është i pari në listën e bashkëngjitur si Aneksi 1.
- 3.1.2.** Nëse gjykata e shkallës së parë ka selinë e saj brenda juridiksionit territorial të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës dhe numri i lëndës së Gjykatës Supreme nuk është çift, lënda i caktohet gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën Supreme, i cili është i pari në listën e bashkëngjitur si Aneksi 1.
- 3.1.3.** Nëse gjykata e shkallës së parë ka selinë e saj brenda juridiksionit territorial të Gjykatave të Qarkut të Pejës ose të Mitrovicës, lënda i caktohet gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën Supreme, i cili është i treti në listën e bashkëngjitur si Aneksi 1.
- 3.1.4.** Nëse gjykata e shkallës së parë ka selinë e saj brenda juridiksionit territorial të Gjykatave të Qarkut të Prizrenit ose të Gjilanit, lënda i caktohet gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën Supreme, i cili është i katërti në listën e bashkëngjitur si Aneksi 1.
- 3.1.5.** Nëse gjyqtari të cilit duhet t'i caktohet lënda nuk është i pranishëm për shkak të përjashtimit ligjor, mungesës në ditën e shqyrtimit/seancës apo arsyeve të tjera të rëndësishme, lënda i caktohet Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të BE-së. Nëse Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të BE-së nuk është e pranishme për shkak të mungesës në ditën e shqyrtimit/seancës apo arsyeve të tjera, lënda i caktohet gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën Supreme, emri i të cilit është pas emrit të gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën Supreme në listën e bashkëngjitur si Aneksi 1, në përputhje me nenin 3.1.1 deri në nenin 3.

3.2.Caktimi i anëtarëve të kolegjit:

- 3.2.1.** Është e pëlqyeshme që anëtarët e kolegjit të jenë gjyqtarë vendorë të Gjykatës Supreme të caktuar në lëndë penale. Këta gjyqtarë vendorë do të caktohen në kolegje në bazë të orarit – të bashkangjitur si Aneksi 2 – i cili përmban të gjithë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të caktuar në lëndë penale.
- 3.2.2.** Caktimi i këtyre gjyqtarëve në kolegje do bëhet sipas emrave në renditje sipas alfabetit.
- 3.2.3.** Nëse gjyqtari vendor i cilit duhet të caktohet në kolegji nuk është i pranishëm për shkak të përjashtimit, mungesës në ditën e shqyrtimit/seancës apo arsyeve të tjera të rëndësishme, ai apo ajo zëvendësohet nga gjyqtari vendor emri i të cilit pason sipas orarit.
- 3.2.4.** Nëse një gjyqtar i EULEX-it kërkohet si anëtar i kolegjit, ai apo ajo caktohet në kolegji në bazë të orarit i cili përmban të gjithë emrat e gjyqtarëve penalë në Gjykatën Supreme, përfshirë këtu edhe emrin e Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të BE-së. Caktimi i anëtarit të kolegjit do të bëhet sipas emrit në renditje alfabetike. Nëse ky gjyqtar nuk është i pranishëm për shkak të përjashtimit, mungesës në ditën e shqyrtimit/seancës apo arsyeve të tjera të rëndësishme, ai apo ajo zëvendësohet nga një gjyqtar i EULEX-it i Gjykatës Supreme emri i të cilit pason sipas orarit. Gjyqtari i cili është zëvendësuar do të caktohet si anëtar i kolegjit të ardhshëm.

4. Ankesat kundër aktgjykimeve në shkallën e tretë dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike:

4.1.Caktimi i kryetarit të kolegjit:

Lëndët aktgjykimi i të cilave është ankimuar në shkallën e tretë dhe lëndët në të cilat ankuesi kërkon mjet të jashtëzakonshëm juridik u caktohen gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën Supreme në përjashtim të Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të BE-së, sipas këtij rendi:

- 4.1.1.** Nëse gjykata e shkallës së parë ka selinë e saj brenda juridiksionit territorial të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës dhe numri i lëndës së Gjykatës Supreme është çift, lënda i caktohet gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën Supreme, i cili është i pari në listën e bashkëngjitur si Aneksi 1.
- 4.1.2.** Nëse gjykata e shkallës së parë ka selinë e saj brenda juridiksionit territorial të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës dhe numri i lëndës së Gjykatës Supreme nuk është çift, lënda i caktohet gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën Supreme, i cili është i dyti në listën e bashkëngjitur si Aneksi 1.
- 4.1.3.** Nëse gjykata e shkallës së parë ka selinë e saj brenda juridiksionit territorial të Gjykatave të Qarkut të Pejës ose të Mitrovicës, lënda i caktohet gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën Supreme, i cili është i treti në listën e bashkëngjitur si Aneksi 1.
- 4.1.4.** Nëse gjykata e shkallës së parë ka selinë e saj brenda juridiksionit territorial të Gjykatave të Qarkut të Prizrenit ose të Gjilanit, lënda i caktohet gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën Supreme, i cili është i katërti në listën e bashkëngjitur si Aneksi 1.
- 4.1.5.** Nëse gjyqtari të cilit duhet t'i caktohet lënda nuk është i pranishëm për shkak të përjashtimit ligjor, mungesës në ditën e shqyrtimit/seancës apo arsyeve të tjera të rëndësishme, lënda i caktohet Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të BE-së. Nëse Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të BE-së nuk është e pranishme për shkak të mungesës në ditën e shqyrtimit/seancës apo arsyeve të tjera, lënda i caktohet gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën Supreme, emri i të cilit është pas emrit të gjyqtarit të EULEX-it në Gjykatën Supreme në listën e bashkëngjitur si Aneksi 1, në përputhje me nenin 4.1.1 deri në nenin 4.

4.2.Caktimi i anëtarëve të kolegjit:

- 4.2.1.** Është e pëlqyeshme që anëtarët e kolegjit të jenë gjyqtarë vendorë të Gjykatës Supreme të caktuar në lëndë penale. Këta gjyqtarë vendorë do të caktohen në kolegje në bazë të orarit – të bashkëngjitur si Aneksi 2 – i cili përmban të gjithë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të caktuar në lëndë penale.
- 4.2.2.** Caktimi i këtyre gjyqtarëve në kolegje do bëhet sipas emrave në renditje sipas alfabetit.

- 4.2.3.** Nëse gjyqtari vendor i cilit duhet të caktohet në kolegji nuk është i pranishëm për shkak të përjashtimit, mungesës në ditën e shqyrtimit/seancës apo arsyeve të tjera të rëndësishme, ai apo ajo zëvendësohet nga gjyqtari vendor emri i të cilit pason sipas orarit. Gjyqtari i cili është zëvendësuar do të caktohet si anëtar i kolegjit të ardhshëm
- 4.2.4.** Nëse një gjyqtar i EULEX-it kërkohet si anëtar i kolegjit, ai apo ajo caktohet në kolegji në bazë të orarit i cili përmban të gjithë emrat e gjyqtarëve penalë në Gjykatën Supreme, përfshirë këtu edhe emrin e Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të BE-së. Caktimi i anëtarit të kolegjit do të bëhet sipas emrit në renditje alfabetike. Nëse gjyqtari nuk është i pranishëm për shkak të përjashtimit, mungesës në ditën e shqyrtimit/seancës apo arsyeve të tjera të rëndësishme, ai apo ajo zëvendësohet nga gjyqtari i EULEX-it në Gjykatën Supreme emri i të cilit pason sipas orarit, ose në rast të pamjaftueshmërisë së orarit nga një Gjyqtarë tjetër i EULEX-it në Gjykatën Supreme. Gjyqtari i cili është zëvendësuar do të caktohet si anëtar i kolegjit të ardhshëm

5. Ankesat ose procedurat tjera ligjore:

Në rast të ankesave ose procedurave ligjore të cilat nuk përmenden përmes rregullave të mësipërme, zbatohen parimet e përcaktuara në nenin 3 (ankesat kundër aktgjykimeve).

Aneksi 1**Individualizimi i Kryetarit të kolegjit****Ankesat kundër aktvendimeve**

Lars Dahlstedt – 4/5 September

Martti Harsia

Norbert Koster

Gerrit-Marc Sprenger

Ankesat kundër aktgjykimeve në shkallën e dytë

Lars Dahlstedt – 4/5 September

Gerrit-Marc Sprenger

Norbert Koster

Martti Harsia

Ankesat kundër aktgjykimeve në shkallën e tretë dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike

Norbert Koster

Martti Harsia

Lars Dahlstedt – 4/5 September

Gerrit-Marc Sprenger

Aneksi 2

Emine Mustafa

Nesrin Lushta

Marije Ademi

Aneksi 3**Asphaug Karen**– 28/29 August 2010**Buatier de Mongeot** Ferdinando**Buzova** Rositza**Charpentier** Caroline**Entchev** Nikolay**Florit** Francesco**Gallo** Gianfranco**Huener** Klaus**Jaakkola** Riku**Jakimko** Witold**Jung** Klaus**Kanev** Vladimir**Karpati** Hajnalka**Klonowiecka Milart** Agnieszka**Lindemann Proetel** Christine**Micheva-Ruseva** Verginia**Oyhaugen** Gynnar – 4/5 September**Pardal** Vitor**Risch** Ingo**Sedek** Arkadiusz**Schokkenbroek** Johanna**Simmons** Malcolm**Smith** Charles**Yordanov** Dragomir**Welford Carroll** Jonathan Neil